

20211031638

## **L I G J**

### **PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT TË PUNËSIMIT TË PERSONAVE ME INVALIDITET**

#### Neni 1

Në Ligjin e Punësimit të Personave me Invaliditet (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 44/2000, 16/2004, 62/2005, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 161/2008, 99/2009, 136/11, 129/15, 147/15, 27/16 dhe 99/18), në nenin 20, paragrafi 1, fjalët: “2.000 euro në kundërvlerë denari” zëvendësohen me fjalët: “200 deri 500 euro në kundërvlerë denari - për mikro tregtarë, nga 500 deri 700 euro në kundërvlerë denari - për tregtarë të vegjël, nga 700 deri 1000 euro në kundërvlerë denari - për tregtarë të mesëm dhe nga 1.000 deri 2.000 euro për tregtarë të mëdhenj”.

Në paragrafin 2 fjalët: “30% të gjobës së përlogaritur për shoqërinë mbrojtëse” zëvendësohen me fjalët: “100 deri 250 euro në kundërvlerë denari”.

#### Neni 2

Në nenin 20-a, paragrafi 1, fjalët: “2.000 euro në kundërvlerë denari” zëvendësohen me fjalët: “200 deri 500 euro në kundërvlerë denari - për mikro tregtarë, nga 500 deri 700 euro në kundërvlerë denari - për tregtarë të vegjël, nga 700 deri 1.000 euro në kundërvlerë denari - për tregtarë të mesëm dhe nga 1.000 deri 2.000 për tregtarë të mëdhenj”.

Në paragrafin 2, fjalët: “30% të gjobës së përlogaritur për personin juridik” zëvendësohen me fjalët: “100 deri 250 euro në kundërvlerë denari”.

#### Neni 3

Në nenin 21, paragrafi 1, fjalët: “2.000 euro në kundërvlerë denari” zëvendësohen me fjalët: “200 deri 500 euro në kundërvlerë denari - për mikro tregtarë, nga 500 deri 700 euro në kundërvlerë denari - për tregtarë të vegjël, nga 700 deri 1.000 euro në kundërvlerë denari - për tregtarë të mesëm dhe nga 1.000 deri 2.000 euro në kundërvlerë denari - për tregtarë të mëdhenj”.

Në paragrafin 2, fjalët: “30% të gjobës së përlogaritur për personin juridik” zëvendësohen me fjalët “100 deri 250 euro në kundërvlerë denari”.

#### Neni 4

Në nenin 22, paragrafi 1, fjalët: “2.000 euro në kundërvlerë denari” zëvendësohen me fjalët: “200 deri 500 euro në kundërvlerë denari - për mikro tregtarë, nga 500 deri 700 euro në kundërvlerë denari - për tregtarë të vegjël, nga 700 deri 1.000 euro në kundërvlerë denari - për tregtarë të mesëm dhe nga 1.000 deri 2.000 euro në kundërvlerë denari - për tregtarë të mëdhenj”.

Në paragrafin, 2 fjalët: “30% të gjobës së përlogaritur për personin juridik” zëvendësohen me fjalët: “100 deri 250 euro në kundërvlerë denari”.

Në paragrafin 3, fjalët: “1.000 euro në kundërvlerë denari” zëvendësohen me fjalët: “100 deri 250 euro në kundërvlerë denari”.

Në paragrafin 4, fjalët: “30% të gjobës së përlogaritur për personin me invaliditet” zëvendësohen me fjalët: “100 deri 250 euro në kundërvlerë denari”.

Në paragrafët 5 dhe 6, numri “25” zëvendësohet me numrin “20”.

Në paragrafin 7, numri “25” zëvendësohet me numrin ”20”, ndërkaq fjalët: “neni 3” zëvendësohen me fjalët: “neni 16”.

Neni 5

Në nenin 24, paragrafi 1, numri “25” zëvendësohet me numrin “20”, ndërkaj numri “5” fshihet.

Në paragrafin 2, numri “25” zëvendësohet me numrin “20”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.